



**Republika e Kosovës  
Republika Kosova/Republic of Kosovë  
Komuna e Dragashit/Opstina Drgas**

---

**RREGULLORE**

**PËR MBROJTJEN E TË MITURVE NGA DUKURITË QË  
DËMTOJNË SHËNDETIN DHE ZHVILLIMIN E TYRE**

**Në Dragash, 26.11. 2015**

Në bazë të dispozitave të nenit 11, nenit 12.2 shkronja c) dhe nenit 17 shkronja s) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), të dispozitave të nenit 32.2 të Statutit të 01. Nr. 06 - 103/1 dt. 11.09.2008, Kuvendi Komunes së Dragashit në mbledhjen e mbajtur me **26.11.2015.**, miratoi

## **RREGULLOREN**

### **PËR MBROJTJEN E TË MITURVE NGA DUKURITË QË DËMTOJNË SHËNDETIN DHE ZHVILLIMIN E TYRE**

#### **Neni 1**

#### **Dispozitat e përgjithshme**

Me këtë rregullore përcaktohen kushtet për ndalimin e dukurive që dëmtojnë shëndetin dhe zhvillimin e të miturve. Kushtet në të cilat personat fizik, organizatat tregtare dhe shërbyese, mund t'u ofrojnë në shitje ose shërbime tjera që janë të ndaluara me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës, e që dëmtojnë shëndetin dhe zhvillimin e të miturve.

#### **Neni 2**

#### **Përkufizimet**

- 1. Të mitur konsiderohen :** personat prej moshës 14 deri në 18 vjeç.
- 2. Të mitur të rijnë konsiderohen:** Personat prej moshës 14 deri 16 vjeç, ndërsa personat prej moshës 16 deri 18 vjeç janë të mitur të rritur.
- 3. Dukuri negative që dëmtojnë shëndetin dhe zhvillimin e të miturve konsiderohen:** konsumimi i alkoolit, duhanit, narkotikëve të ndryshëm, shfaqjet degjeneruese, frekuentimi i të rinjve në lokalet e ndryshme në orët e vona etj.
- 4. Vende publike janë:** hapësirat, lokalet e ndryshme hoteliere shërbyese dhe tregtare, kafiteritë, internet kafet, institucionet kulturore, objektet edukativo-arsimore, kinematë dhe lokalet e natyrës së tillë.

#### **Neni 3**

- 1.** Ndalohet rreptësisht shitja dhe përdorimi i të gjithave pijeve alkoolike dhe duhanit brenda objekteve edukativo-arsimore.
- 2.** Të gjitha subjektet nga neni 2 paragrafi 5 të kësaj rregullore, janë të obliguara që në hyrje apo në brendi të vendosin tabelën (shenjën) për ndalimin e shitjes dhe shërbimit të pijeve alkoolike dhe duhanit për të mitur, konform dispozitave të kësaj rregulloreje.
- 3.** Ndalohet shitja dhe shërbimi i pijeve alkoolike për të miturit nga subjektet afariste.
- 4.** Ndalohet shitja dhe shërbimi me duhan, apo çdo lloj tjetër i duhanit të miturve nga subjektet tregtare që merren me shitjen dhe shërbimin e tyre.
- 5.** Të miturit e rritur mund të shesin pije alkoolike dhe duhan, vetëm në prani ose me leje dhe pëlqim të prindërve apo kujdestarit ligjor, në objektet që posedojnë leje përkatëse.
- 6.** Ndalohet rreptësisht që personat nën moshën 16 vjeçare të shesin pije alkoolike dhe duhan.

**Neni 4**  
**Obligimet e subjekteve të bizneseve ndaj të miturit**

1. Të miturit nën moshën 16 vjeçare, mund të qëndrojnë në lokalet në të cilat shërbehet alkooli vetëm në prani të prindit ose kujdestarit ligjor.
2. Të miturit e rritur mund të qëndrojnë deri në ora 20:00, ndërsa pas orës 20:00, vetëm në prani të prindit apo kujdestarit ligjor.
3. Ndalohet hyrja e të miturve në lokalet si: loto, bingo, prognoza sportive apo lojëra fati.
4. Organizatorët e shfaqjeve të ndryshme, programeve dhe manifestimeve publike dhe kulturore për të rinjtë në lokalet e mbyllura janë përgjegjës në rast se në ato lokale, lejohet përdorimi i pijeve alkoolike apo duhanit nga të miturit, në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregullore.

**Neni 5**  
**Kinematë, Internet kafetë dhe Shtypi**

1. Kinematë apo subjektet tjera që merren me shfaqje publike të filmave, janë të detyruara që për fëmijët deri në moshën 14 vjeçare të shfaqin ato deri në ora 16:00, prej moshës 14 deri në 16 vjeçare deri në ora 18:00, ndërsa për të miturit prej 16 deri në 18 vjeç deri në ora 20:00.
2. Pas orës 20:00 shfaqjet e tilla të miturit, mund t'i përcjellin vetëm në prani të prindit apo kujdestarit ligjor.
3. Kinematë, apo subjektet tjera janë të obliguara që me rastin e shfaqjes së filmave, përmbajtja e të cilave ndikon negativisht në formimin e të miturve në aspektin edukativ, arsimor dhe kulturor, të njoftojnë me rastin e reklamimit të filmit si dhe në hyrje të objektit ta kenë shenjën për ndalimin e hyrjes, dhe njëkohësisht janë të obliguara që mos të lejojnë hyrjen e tyre në shfaqje.
4. Internet kafetë janë të obliguara që ta ndalojnë hapjen e web-faqeve të cilat ndikojnë negativisht në formimin e personalitetit dhe edukimit të tyre.
5. Botuesit dhe shitësit e revistave të ndryshme, përmbajtja e të cilave është degjeneruese dhe të cilat ndikojnë negativisht në edukimin arsimor, shëndetësor dhe kulturor të të miturve, nuk mund t'ua shesin të miturve deri në moshën 18 vjeçare.
6. Video klubet apo subjektet që merren me shitjen e videokasetave, DVD-ve, CD-ve, përmbajtja e të cilave është degjeneruese, janë të obliguara që të mos u shesin dhe të mos u lejojnë përdorimin e tyre, të miturve

**Neni 6**

Inspektorët komunal dhe policia do të kujdesen dhe të mbikëqyrin zbatimin e kësaj rregullore nga subjektet përkatëse dhe do të ndërmarrin masat dhe veprimet përkatëse sanksionuese.

**Neni 7**  
**Dispozitat ndëshkuese dhe gjobat**

1. Personi juridik-subjekti afarist, nëse në lokalit të tij shet ose shërben pije alkoolike në kundërshtim me dispozitat nga neni 3 paragrafi 1,3,4,5 dhe 6 të kësaj Rregulloreje, për



kundërvajtjen e kryer, do të dënohet me gjobë, njëjtë siç janë të përcaktuara në nenin 103 pika (1) të Ligjit nr. 2004/16 mbi veprimtarin hoteliere dhe turistike, ndërsa personi fizik që shkel dispozitat e nenit 3 paragrafi 1,3,4,5 dhe 6 të kësaj rregulloreje, dënohet me gjobë mandatore prej 200.00€.

2. Me gjobë mandatore në shumë prej 50.00€ do të dënohen:

2.1. nëse të miturit i lejohet qëndrimi në restorant apo kafiteri etj., në kundërshtim me dispozitat e nenit 4 paragrafi 1 dhe 2 të kësaj rregullore;

2.2. nëse subjektet nga neni 4 paragrafi 4 veprojnë në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregullore;

2.3. organizuesit e shfaqjeve, manifestimeve etj, veprojnë në kundërshtim me dispozitat nga neni 3 paragrafi 4 të kësaj rregullore.

3. Me gjobë mandatore në shumë prej 50.00€ do të dënohen personat përgjegjës të subjekteve nga neni 4, nëse nuk respektohen dispozitat paragrafi 2.1 këtij neni dhe veprojnë në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregulloreje.

### Neni 8

#### Dispozitat kalimtare dhe të fundit

8.1. Dispozitat e kësaj rregullore vlejnë edhe për personat nën moshën 14 vjeçare,

8.2. Nëse subjektet nuk bëjnë pagesën e gjobave të shqiptuara në pajtim me dispozitat e nenit 7 paragrafi 2 dhe 3 të kësaj rregulloreje, në afatin prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh prej ditës së shqiptimit të gjobës, do të iniciohet procedura për ekzekutim në Gjykatën themelore në Dragash

### Neni 9

#### Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Dragashit.

#### Kuvendi i Komunës – Dragash

01. nr.06-19566/3

Dragash më 26.11.2015.\_



Kryesuesi i Kuvendit

Shaban Shabani